



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education,  
and Science*

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 01B - 69

Datë: 06.08.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020, dhe nenit 4, shtojcës 11 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr:

**V E N D I M**

**Për Kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të, për vitin shkollor 2020-2021**

1. Kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të, për vitin shkollor 2020/2021 në pamundësi për mbajtjen e testit të Arritshmërisë për shkak të gjendjes me pandeminë COVID-19 janë si vijon:

1.1. Obligimet e Drejtorive Komunale të Arsimit, ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës janë:

- 1.1.1. Planifikimet e regjistrimeve të nxënësve në klasën e 10-të, të dorëzohet në MASH;
- 1.1.2. Kërkesat për drejtime dhe profile të reja duhet të bëhen në MASH (në divizionet përkatëse);
- 1.1.3. Drejtimet të janë sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK);
- 1.1.4. DKA-të të formojnë komisionet profesionale dhe përkatëse brenda shkolle për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve.

1.2. Në vijim është planifikimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për afatet, kriteret dhe kushtet për regjistrim për vitin shkollor 2020/2021:

- 1.2.1. Shpallja e konkursit më datë 17 gusht 2020 – nga DKA-të;
- 1.2.2. Dorëzimi i dokumenteve më 17-21 gusht 2020;
- 1.2.3. Shpallja e rezultateve më 24 gusht 2020;

1.2.4. Në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve, aplikimi i nxënësve mund të vazhdojë deri me 26 gusht 2020;

1.2.5. Shpallja e rezultateve me 28 gusht 2020;

1.2.6. Konkursi duhet të shpallet edhe në gjuhët e komuniteteve në komunat ku organizohet mësimi në dy e më shumë gjuhë.

1.2.7. MASH, do të bëjë monitorimin e procesit të regjistrimit dhe pranimit.

1.3. Konkursi shpallet duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës.

1.4. **Sqarim:** Drejtimet për shkollat shpallen sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

1.5. Konkursi shpallet me këto kushte dhe kritere:

**1.5.1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

1.5.1.1. Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe shkolla profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

1.5.1.2. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të, jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen certifikatave apo dëftesave në MASH, dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

**1.5.2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

1.5.2.1. Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

1.5.2.1.1. Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron);

1.5.2.1.2. Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

1.5.2.1.3. Certifikatën e lindjes.

1.5.3. Sqarim: shkolla duhet të krijoj kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre.

**2. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

2.1. Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën 17-21 gusht 2020, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

2.2. Publikimi i rezultateve për pranimin e nxënësve:

2.2.1. 24 gusht 2020 (në shkollat ku plotësohet numri).

2.2.2. 28 gusht 2020 (në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).

2.2.3. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24 –31 gusht 2020;

2.2.4. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka

të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, drejtorisë komunale të arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH - komisionit për ankesa.

### **3. Kriteret për regjistrim**

3.1. Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- 3.1.1. Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60%) 60 pikë
- 3.1.2. Nota mesatare nga lëndët prioritare ( klasat 6-9 ) (40%) 40 pikë
- 3.1.3. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

3.2. Lëndet prioritare për drejtimet përkatëse:

#### **3.2.1. Gjimnazi i shkencave natyrore**

- Lënda I – Fizikë;
- Lënda II – Kimi;
- Lënda III – Biologji;
- Lënda IV – Matematikë.

#### **3.2.2. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore**

- Lënda I – Gjuhë amtare;
- Lënda II – Gjuhë angleze;
- Lënda III – Histori;
- Lënda IV – Gjeografi.

#### **3.2.3. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari**

- Lënda I – Fizikë;
- Lënda II – Kimi;
- Lënda III – Biologji;
- Lënda IV – Gjuhë amtare.

#### **3.2.4. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji**

- Lënda I – Fizikë;
- Lënda II – Kimi;
- Lënda IV – Matematikë;
- Lënda V – TIK.

#### **3.2.5. Ekonomi**

- Lënda I – Gjuhë amtare;
- Lënda III – Gjeografi;
- Lënda IV – Matematikë;
- Lënda V – TIK.

#### **3.2.6. Juridik, Tregti, Hotelieri dhe Turizëm**

- Lënda I – Gjuhë amtare;

Lënda II – Gjuhë angleze;  
Lënda III – Histori;  
Lënda IV – Gjeografi.

### 3.2.7. Shkollat Artistike

#### 3.2.7.1. Kriteret specifike për regjistrim në shkolla të muzikës:

- 3.2.7.1.1. Drejtimi pedagogjik: profili bashkëpunëtor muzikor;  
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. 9);
- 3.2.7.1.2. Drejtimi instrumental: nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. 9) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. 1-6 ose 1-8 – varësisht nga instrumenti);
- 3.2.7.1.3. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e 10 – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

## 4. Kriteret e përgjithshme për llogaritjen e pikëve

- 4.1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 60 pikë. Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:  $(mes.kl.6 + mes.kl.7 + mes.kl.8 + mes.kl.9) \times 3 = 60$  pikë max.
- 4.2. Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 40 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2.  
 $(mes.lënda(I) + mes.lënda(II) + mes.lënda(III) + mes.lënda(IV)) \times 2 = 40$  pikë Max.
- 4.3. Në rast se nuk mund të bëhet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barabarta do të merren parasysh edhe këto kritere shtesë.  
Suksesi në klasat 1-5 mblidhet nota mesatare e 5 viteve dhe pjesëtohet me 5 pikë.

- 4.3.1. Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të diturisë.....5 pikë
- 4.3.2. Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë.....5 pikë
- 4.3.3. Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë.....4 pikë
- 4.3.4. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë.....3 pikë
- 4.3.5. Vendi i parë në gara komunale të diturisë.....3. pikë
- 4.3.6. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë.....2 pikë
- 4.3.7. Vendi i tretë në gara komunale të diturisë.....1 pikë

4.4. Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabartë, atëherë shkolla për këta kandidatë organizon vlerësim apo testim.

4.5. Vërejtje: Varësisht prej fluksit të nxënësve, shkollat të formojnë më shumë komisione të pranimit të dokumentacionit si dhe të caktojnë staf mbështetës për të mbikëqyrur respektimin e masave edhe në oborr të shkollës.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër 01B-69
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### **A r s y e t i m**

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë dhe nevojës për përcaktimin e Kushteve, kritereve dhe afateve të regjistrimit të nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në pamundësi të mbajtjes së testit të Arritshmërisë për shkak të pandemisë Covid-19 në vendin tonë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas planit dinamik të punës për mbarëvajtjen e përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2020/2021, ka përcaktuar që konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2020/2021, do ta publikojnë Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Të gjitha shkollat e mesme të larta, duhet të përgatitën për pranimin e dokumentacionit nga nxënësit aplikues duke dezinfektuar ambientin shkollor dhe duke respektuar masat e ndërmarra nga Institucionet Përkatese, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Vendimi u dërgohet:**

1. Kabinetit të Ministrit/MASH;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm
3. DKA
4. Departamentit Ligjor
5. Arkivit

